

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

PËRAFRIMI ME GDPR DHE SFIDAT E
ZBATIMIT TË LIGJIT TË RI PËR
MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE NË SHQIPËRI

Haxhire VEZI



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3.

Tel: +355 44 104 247

E-mail: info@em-al.orgWeb: www.em-al.org**AUTORË**

Haxhire VEZI

VITI I PUBLIKIMIT

prill 2026

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Risite e Përforcimit të të Drejtave të Individëve	04
Rritja e Përgjegjësisë për Bizneset	06
Rëndësia e Rritur e DPO - Nëpunësi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale	07
Sifdat e Implementimit	08
Përfundime	09
REFERENCA	10

Fusha e mbrojtjes së të dhënave personale ka rëndësi themelore në ditët kur jeta jonë po zhvillohet me ritme të shpejta virtuale. Pagesat, nënshkrimet e kontratave, deklarata, hapja e llogarive të ndryshme dhe shumë të tjera, po ndodhin në kohë reale dhe duke siguruar mbledhjen e një sërë informacionesh dhe të dhënave tona personale. Shteti ynë, për tu përgjigjur ndryshimeve por edhe rrugës së përafrimit të legjislacionit tone me atë të Bashkimit Europian, miratoi Ligjin Nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹”, i cili hyri në fuqi më 1 shkurt 2025.

Referuar Raport (Progresit) të fundit të vitit 2025, BE shprehet se: “Kudri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale është i përshtatshëm, por kapacitetet e Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ende duhet të përmirësohen. Progresi mirë është arritur me miratimin e Ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale në dhjetor 2024, në përputhje të plotë me *acquis-in* e BE-së. Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin efektiv të këtij kudri, përfshirë forcimin e kapaciteteve administrative dhe buxhetore. Nevojiten gjithashtu masa të mëtejshme për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe për forcimin e kapaciteteve parandaluese të institucioneve publike.”²

Referuar rekomandimeve të mësipërme, nxirret në pah se, qëllimi kryesor i ligjit të ri, referuar tërësisë është përmirësimi i mbrojtjes së të dhënave personale dhe përafrimi i tij me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) të Bashkimit Europian³. Ligji i ri ndër të tjera synon të forcojë mbrojtjen

efektive të të dhënave përmes rritjes së përgjegjshmërisë së kontrolluesve dhe përpunuesve, të sigurojë një mbikëqyrje funksionale të zbatimit duke forcuar rolin e Komisionerit, si dhe të mundësojë maksimizimin e përpjekjeve të Shqipërisë ofrimin e një niveli të përshtatshëm mbrojtjeje sipas standardeve të BE-së.

Risitë e Përforcimit të të Drejtave të Individëve

Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i kushton një kapitull të posaçëm të drejtave të subjektit të të dhënave (Kapitulli II, nenet 12–20), duke përcaktuar mekanizmat për mbrojtjen dhe ushtrimin e tyre në praktikë, të cilat përbëjnë një shtyllë thelbësore të kuadrit ligjor për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Në radhë të parë, e drejta për informim siguron që subjekti i të dhënave të jetë i njoftuar në mënyrë të qartë, të saktë dhe transparente mbi përpunimin e të dhënave të tij personale, përfshirë qëllimin, bazën ligjore, kategoritë e të dhënave dhe të drejtat që i garantohen nga ligji. Kjo e drejtë përbën parakusht për ushtrimin efektiv të të drejtave të tjera.

E drejta për akses i jep subjektit mundësinë të marrë konfirmim nëse të dhënat e tij personale përpunohen dhe, nëse po, të ketë akses në këto të dhëna, si dhe në informacionin përkatës mbi mënyrën e përpunimit të tyre. Në vijim, e drejta për korrigjim dhe fshirje u mundëson subjekteve të kërkojnë korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota, si dhe fshirjen e tyre në rastet e parashikuara nga ligji.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet të drejtës për t’u harruar, e cila u lejon subjekteve të kërkojnë fshirjen e të dhënave personale kur përpunimi nuk është më i nevojshëm, kur mungon baza ligjore, ose kur të dhënat janë përpunuar në kundërshtim me ligjin. Kjo e drejtë forcon

mbrojtjen e privatësisë, veçanërisht në mjedisin dixhital. Po ashtu, ligji njeh të drejtën për kufizimin e përpunimit, duke i dhënë subjektit mundësinë të kërkojë pezullimin e përkohshëm të përpunimit të të dhënave në rrethana të caktuara, si dhe të drejtën për transferueshmërinë e të dhënave, e cila u mundëson subjekteve të marrin të dhënat e tyre në një format të strukturuar dhe të lexueshëm, ose t’i transferojnë ato te një kontrollues tjetër.

Subjekti i të dhënave gëzon gjithashtu të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale, veçanërisht kur përpunimi bazohet te interesi publik ose interesi legjitim i kontrolluesit. Së fundi, ligji garanton të drejtën për të mos iu nënshtruar vendimeve të bazuara ekskluzivisht në përpunimin automatik, përfshirë profilizimin, në rastet kur këto vendime prodhojnë pasoja juridike ose ndikojnë ndjeshëm te subjekti i të dhënave.

Në tërësinë e tyre, këto të drejta synojnë të vendosin subjektin e të dhënave në qendër të procesit të përpunimit, duke garantuar një nivel të lartë mbrojtjeje dhe duke forcuar besimin ndaj përdorimit të të dhënave personale.

Si një e drejtë e parashikuar për herë të parë në ligjin e ri, ‘e drejta për t’u harruar’ përbën një risi thelbësore, e cila meriton vëmendje dhe analizë të veçantë, për shkak të rolit të saj qendror në forcimin e mbrojtjes së privatësisë dhe kontrollit të subjektit mbi të dhënat personale. Në legjislacionin e ri, theksohet posaçërisht se e drejta për t’u harruar, u jep qytetarëve të drejtën të kërkojnë fshirjen e të dhënave të tyre kur ato nuk janë më të domosdoshme ose kur përpunimi është i paligjshëm. Ky parim, i cili

nuk ekzistonte në përkon me nenin 17 të GDPR-së dhe përfaqëson një hap të madh drejt fuqizimit të të drejtave të individit ndaj kontrolluesve dhe përdoruesve teknologjikë.

E drejta për tu harruar si nocion është vlerësuar si një nga risitë më të rëndësishme që solli Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Kjo e drejtë, e parashikuar në nenin 17 të GDPR⁴, i jep individit mundësinë të kërkojë fshirjen e të dhënave personale kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur, kur përpunimi është i paligjshëm ose kur individit ka tërhequr pëlqimin e dhënë më parë. Në këtë mënyrë, individët marrin një kontroll më të madh mbi gjurmët e tyre dixhitale dhe mund të kufizojnë ekspozimin e panevojshëm të informacionit personal në hapësirën publike.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute. Ajo nuk mund të ushtrohet nëse fshirja e të dhënave cenon ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informacionit, përmbushjen e një detyrimi ligjor, interesin publik në fushën e shëndetit, ose nëse të dhënat janë të domosdoshme për qëllime kërkimore, arkivore ose për ushtrimin e kërkesave ligjore. Për këtë arsye, e drejta për t'u harruar duhet të kuptohet si një ekuilibër mes mbrojtjes së privatësisë së individit dhe interesave më të gjera shoqërore.

Gjykatat kanë pasur një sërë çështjesh ku janë ngritur çështje për interpretim mbi të "drejtën për tu harruar", ku një ndër to është edhe CJEU, judgment of 8 December 2022, Google (De-referencing of allegedly inaccurate content), C-460/20, EU:C:2022:962.⁵

Në këtë rast, dy menaxherë të lartë të një grupi kompanish investimi kundërshtuan refuzimin e Google për të hequr nga rezultatet e kërkimit disa artikuj të vitit 2015 që pretendohesh se përmbanin informacione të pasakta dhe imazhe miniaturë të shfaqura pa kontekst. Pasi u përballën me refuzimin e Google, ata e paraqitën çështjen në gjykatën gjermane dhe Gjykata Federale Gjermane e Drejtësisë i bëri një kërkesë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian (GJDBE-së) për një vendim paraprak mbi interpretimin e GDPR-së dhe Direktivës 95/46/KE.

Në këtë vendim, GJDBE-ja vendosi që nëse një pjesë e përmbajtjes së referuar është qartësisht e pasaktë dhe liria e shprehjes nuk mund të jetë më e rëndësishme se e drejta e individit për mbrojtjen e të dhënave. Ndërsa barrën e provës në raste të tilla e mbart kërkuesi, që duhet të ofrojë prova relevante të pasaktësisë, pasi nuk mund të pritët që motorët e kërkimit të hetojnë vetë faktet.

Nëse provat tregojnë qartë pasaktësinë e përmbajtjes, Google duhet ta heqë përmbajtjen, por nëse pasaktësia nuk është e dukshme, heqja mund të detyrohet vetëm nga një gjykatë ose autoritet shtetëror. Lidhur me miniaturat, Gjykata kërkoi një test të veçantë balancimi, duke u përqendruar në vlerën e tyre informative të pavarur dhe çdo tekst shoqëruar në rezultatet e kërkimit.

Më tej, neni 17 përcakton të drejtën për kufizimin e përpunimit, duke lejuar individin të kërkojë pezullim të përkohshëm të përpunimit në raste të caktuara, ndërsa neni 18 njeh të

drejtën e transferueshmërisë së të dhënave, që i jep mundësinë subjektit të marrë të dhënat në një format të strukturuar dhe t'i transferojë ato tek një kontrollues tjetër pa pengesa. Në këtë mënyrë, ligji i ri i forcon të drejtat e individëve, duke siguruar një mbrojtje më të plotë të privatësisë dhe duke u përfruar me standardet e përcaktuara nga GDPR.

Tjetër komponent i ri mbi subjektet e zbatimit të këtij ligji, shihet qartë që është shtrirja ekstra territoriale të drejtës për të dhënat personale, duke zgjeruar fushën e zbatimit edhe ndaj kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave që janë të vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur:

- përpunimi i të dhënave lidhet me ofrimin e mallrave ose shërbimeve për subjekte të të dhënave që ndodhen në Shqipëri;
- përpunimi i të dhënave lidhet me monitorimin e sjelljes së subjekteve të të dhënave që ndodhen në Shqipëri; ose
- kontrolluesi apo përpunuesi është i vendosur jashtë Shqipërisë, por legjislacioni shqiptar zbatohet në bazë të së drejtës ndërkombëtare publike.

Në këto raste, kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave të vendosur jashtë Shqipërisë kanë detyrimin të caktojnë një përfaqësues të vendosur në territorin e Shqipërisë, i cili njoftohet zyrtarisht pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky përfaqësues është i autorizuar të veprojë për dhe/ose së bashku me kontrolluesin apo përpunuesin, për të trajtuar çdo çështje që lidhet me përpunimin e të dhënave, përfshirë komunikimin me Komisionerin dhe me subjektet e të dhënave, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me ligjin e ri.⁶

Rritja e Përgjegjësisë për Bizneset

Ligji përcakton gjithashtu se kontrolluesi mund të përdorë vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për respektimin e standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave, ndërsa përpunuesit nuk mund të angazhojnë palë të tjera pa autorizimin e posaçëm të kontrolluesit. Si pjesë e përgjegjësisë, çdo kontrollues duhet të mbajë dokumentacion të plotë për aktivitetet e përpunimit, si në formë të shkruar, ashtu edhe elektronike, duke demonstruar kështu përputhshmërinë me ligjin.

Për të siguruar integritetin e të dhënave, ligji kërkon masa teknike dhe organizative që garantojnë një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut. Në rast të cenimit të të dhënave personale, Komisioneri duhet të njoftohet dhe, kur rreziku është i lartë, edhe vetë subjektet e të dhënave. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nga çdo kontrollues dhe përpunues, si dhe kryerja e vlerësimeve të ndikimit përpara përdorimit të teknologjive të reja, për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme ndaj të drejtave të individëve.⁷

Në kuadrin e ri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale, sanksionet janë përfruar me GDPR-në, duke parashikuar gjoba deri në 4% të xhiros vjetore globale ose 2 miliardë lekë (20 milionë euro). Ky sistem e vendos Shqipërinë në linjë me BE-në dhe forcon rolin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave, i cili ka kompetencë për hetim dhe vendosje

sanksionesh administrative me shuma goxha të mëdha. Megjithatë, niveli i lartë i gjobave, edhe pse është i njëjtë me një kompani që bën një shkelje të tillë në Gjermani, Itali apo shtete të tjera të BE-së, nga ana tjetër mund të jetë sfidues për bizneset e vogla e të mesme shqiptare duke pasur parasysh edhe kapacitetet e tyre, gjë e cila duket si në plan të parë si një normë e përafuar me GDPR-në, por a është e përafuar edhe me realitetin ekonomik-financiar të bizneseve në Shqipëri?! Vështirë se mund ta themi.

Rëndësia e Rritur e DPO (Data Protection Officer) - Nëpunësi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i jep një rol të posaçëm Oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale (DPO), duke e pozicionuar si figurë qendrore në garantimin e zbatimit të standardeve të mbrojtjes së të dhënave. Krahasuar me kuadrin ligjor të mëparshëm, ligji i ri jo vetëm që saktëson detyrimet e DPO-së, por edhe forcon kriteret për përzgjedhjen dhe ushtrimin e funksioneve të tij, duke e përafuar këtë rol me praktikën më të mira europiane, në veçanti me GDPR.

Por a mund të jetë kushdo Nëpunës i mbrojtjes së të dhënave? Në fakt, në ligj përcaktohet se Nëpunësi caktohet në bazë të aftësive profesionale të certifikuara dhe, në veçanti, në bazë të njohurive të mira të ligjit dhe praktikave të mbrojtjes së të dhënave, si dhe të aftësisë për

të përmbushur detyrat e tij⁸. Nuk dihen ende detaje se kujt i referohet certifikimi, por priten më tej sqarimi i konceptit të tij edhe nëpërmjet akteve të tjera nënligjore.

Për bizneset dhe institucionet që përpunojnë të dhëna personale në mënyrë të gjerë, pasja e një DPO-je është tashmë një domosdoshmëri ligjore dhe praktike. DPO shërben si:

- garantues i brendshëm i përputhshmërisë me ligjin,
- këshillues i menaxhimit dhe
- njëkohësisht si pikë kontakti me autoritetin mbikëqyrës.

Kjo rrit transparencën, përgjegjësinë dhe sigurinë në proceset e përpunimit të të dhënave.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është pavarësia që i garantohet DPO-së. Ligji përcakton se ai nuk duhet të marrë udhëzime mbi kryerjen e detyrave të tij, si dhe nuk duhet të penalizohet për ushtrimin e përgjegjësisë ligjore. Kjo dispozitë synon të sigurojë integritetin profesional dhe mbrojtjen e interesave të individëve. Për më tepër, ligji i ri përcakton kriteret më të qarta për kualifikimin e DPO-së, duke theksuar nevojën për njohuri të specializuara në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe të kuadrin juridik përkatës.

Në këtë kuptim, funksioni i DPO-së përfaqëson një element kyç në arkitekturën ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale, duke u bërë një mekanizëm që jo vetëm rrit ndërgjegjësimin dhe respektimin e rregullave brenda organizatave, por edhe kontribuon drejtpërdrejt në sigurinë juridike dhe në ndërtimin e besimit të qytetarëve ndaj përpunuesve të të dhënave.⁹

Sifdat e Implementimit

Në (progres) raportin e vitit 2025 për Shqipërinë të BE¹⁰, theksohet në fakt që Shqipëria ka arritur të bëjë progres të konsiderueshëm në përfundimin e rregullave të BE-së mbi mbrojtjen e të dhënave personale me atë të brendshëm, por lihen edhe detyra që konsistojnë në fakt, me implementimin e tyre në praktikë. Në këtë drejtim, mbetet e domosdoshme forcimi i kapaciteteve institucionale të autoritetit mbikëqyrës dhe subjekteve përpunuese, garantimi i aplikimit të parimit të përgjegjshmërisë (accountability), si dhe sigurimi i respektimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave në praktikë. Veçanërisht, proceset e dixhitalizimit të databazave dhe shërbimeve publike kërkojnë masa të shtuara sigurie dhe mekanizma efektivë për parandalimin dhe menaxhimin e shkeljeve të të dhënave personale.

Në kontekstin e Kapitullit 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore të acquis së BE-së, mbrojtja e të dhënave personale përbën një komponent thelbësor të garantimit të së drejtës për privatësi dhe mbrojtjes së të drejtave themelore. Ndërsa kuadri ligjor është në përputhje me legjislacionin BE-së, sfida kryesore mbetet demonstrimi i kapacitetit të zbatimit dhe monitorimit efektiv, përfshirë funksionimin e pavarur dhe të fuqizuar të autoritetit mbikëqyrës.

Njëkohësisht, në lidhje me Kapitullin 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria, garantimi i mbrojtjes së të dhënave personale është

thelbësor në kontekstin e shkëmbimit të informacionit, përdorimit të databazave dhe sistemeve dixhitale, duke kërkuar standarde të larta sigurie dhe respektim të plotë të GDPR-së në praktikë.

Për sa i përket edhe sistemit të kundravajtjeve administrative, shpesh është theksuar mungesa e forcës që Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale has në vjeljen e tyre dhe kjo theksohet edhe më tepër me shifrat e reja që ky ligj i ri përcakton.

Megjithatë, sfida kryesore lidhet me proporcionalitetin dhe zbatueshmërinë praktike të këtij regjimi sanksionues, veçanërisht në kontekstin e strukturës ekonomike të tregut shqiptar. Ndërsa niveli i gjobave është i krahasueshëm me atë që aplikohet për subjekte të ngjashme në shtetet anëtare të BE-së, realiteti ekonomik dhe kapacitetet financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme në Shqipëri janë dukshëm më të kufizuara.

Kjo krijon një rrezik që sanksionet, edhe pse formalisht të harmonizuara me GDPR-në, të rezultojnë disproporcionale në praktikë, duke e bërë respektimin e ligjit më shumë një barrë financiare sesa një mekanizëm nxitës për përputhshmëri.

Në këtë kuadër, mbetet thelbësore që autoriteti mbikëqyrës të aplikojë një qasje të balancuar dhe graduale në vendosjen e sanksioneve, duke marrë parasysh natyrën e shkeljes, madhësinë e subjektit, shkallën e fajësisë dhe kapacitetet reale ekonomike, me qëllim që regjimi sanksionues të jetë jo vetëm i harmonizuar me GDPR-në, por edhe i përshtatur me realitetin ekonomik-financiar të Shqipërisë.

Duhet pasur në konsideratë fakti që, zbatimi i suksesshëm i ligjit nuk varet vetëm nga kuadri normativ apo sa i harmonizuar është ai me legjislacionin e BE-së. Ai kërkon përpjekje të konsiderueshme në edukimin e publikut, trajnimin e bizneseve dhe institucioneve publike, si dhe forcimin e autoritetit mbikëqyrës. Në mungesë të këtyre elementeve, ekziston rreziku që ligji të mbetet vetëm një instrument formal, pa arritur të ofrojë mbrojtjen reale të pritshme. Prandaj, rekomandohet organizimi i fushatave ndërgjegjësuese, ngritja e moduleve të specializuara për trajnimin e DPO-ve, si dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme për autoritetin kompetent. Po ashtu, bashkëpunim me BE-në dhe vendet anëtare mund të ndihmojë përmes shkëmbimit të praktikave më të mira dhe asistencës teknike.

Miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale shënon një ndryshim thelbësor në mënyrën se si subjektet publike dhe private duhet të trajtojnë përpunimin e të dhënave personale në Shqipëri. Në këtë kuadër, bizneset përballen tashmë me një regjim ligjor më kërkues, i cili imponon vigjilencë të shtuar, përgjegjshmëri aktive dhe qasje parandaluese në mbrojtjen e të dhënave personale.

Përputhshmëria me këtë ligj nuk mund të trajtohet më si një detyrim formal, por kërkon marrjen e masave të menjëhershme dhe konkrete, përfshirë rishikimin e proceseve të brendshme, forcimin e masave teknike dhe organizative të sigurisë, trajnimin e stafit dhe krijimin e mekanizmave të vazhdueshme të monitorimit dhe raportimit. Vetëm përmes një

angazhimi proaktiv dhe të qëndrueshëm, bizneset mund të minimizojnë rreziqet ligjore dhe financiare, të garantojnë respektimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe të ndërtojnë besim në marrëdhëniet me klientët dhe partnerët.

Në këtë kontekst, ligji i ri për mbrojtjen e të dhënave personale përbën jo vetëm një sfidë për bizneset, por edhe një mundësi për të përmirësuar standardet e qeverisjes, transparencës dhe sigurisë në një mjedis gjithnjë e më të dixhitalizuar.

Në përfundim, Ligji Nr. 124/2024 përfaqëson një hap thelbësor drejt modernizimit të mbrojtjes së të dhënave personale në Shqipëri. Ai sjell përafrim të dukshëm me *acquis* e BE-së dhe garanton standarde më të larta të privatësisë për qytetarët shqiptarë. Le të themi që në aspektin de jure është bërë arritje në hartimin dhe miratimin e tij për ta pasur në fuqi ditët e sotme, dhe zbatimi i tij në praktikë mbetet ende për tu parë, jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe si e drejtë themelore e individit.

[1] LIGJ Nr. 124/2024 “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”, aksesohet në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/12/19/124/921d3810-ab2a-4e45-bdca-bef3a84b2721>

[2] Raporti i Komisionit European 2025, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf, fq. 35

[3] <https://gdpr-info.eu/> aksesuar më 09.09.2025

[4] European Union. (2016). Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation). Official Journal of the European Union.

[5] <https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=268429&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=200689>

[6] <https://kpmg.com/al/en/insights/2025/02/new-law-on--personal-data-protection-.html> aksesuar më 19.12.2025

[7] Neni 26, LIGJ Nr. 124/2024 “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”, aksesohet në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/12/19/124/921d3810-ab2a-4e45-bdca-bef3a84b2721>

<https://gdpr-info.eu/> aksesuar më 09.09.2025. Neni 26 Përpunuesi

1. Kur përpunimi kryhet për llogari të një kontrolluesi, kontrolluesi është i detyruar të përdorë vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative, në mënyrë që përpunimi të kryhet në përputhje me këtë ligj e të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave.

2. Përpunuesi nuk angazhon përpunues tjetër pa autorizimin paraprak, specifik ose të përgjithshëm, me shkrim të kontrolluesit. Në rastin e një autorizimi të

përgjithshëm me shkrim, përpunuesi informon kontrolluesin për çdo ndryshim që synon të kryejë lidhur me shtimin ose zëvendësimin e përpunuesve të tjerë, duke i dhënë kontrolluesit mundësinë e kundërshtimit të këtyre ndryshimeve.

[8] Neni 34 Detyrat dhe pozicioni i nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale, Ligji nr. 124/2024

[9] Ligji nr. 124/2024, neni 37–40; GDPR, neni 37–39.

[10] https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf aksesuar më 19.12.2025